



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:165757

Datë: 13.01.2021

Numri i dokumentit: 01404005

**P nr.1004/2020**

## NË EMËR TË POPULLIT

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni**

**Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, dhe ate gjyqtari Elmaz Zenuni, me sekretaren juridike Igballe Arifi, në lëndën penale kundër të akuzuarit I.R.nga fshati ..... komuna e Shtimës, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr.1446/2020 të datës 25.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor me datën 13.01.2021, në prezencën e prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, dhe të akuzuarit, të njejtën ditë muar, njashtu me datën 13.01.2021, me shkrim përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari, I.R.**nga fshati ..... komuna e Shtimës, i lindur me ..... në fshatin ..... të Shtimës, nga i ati H. dhe e ëma F.e gjinisë H., ka të kryer shkollën fillore, i martuar baba i 5 (pesë) fëmijëve , i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, me nr. personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

### ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 19.10.2020 rreth orës 13:30 në Pyllin publik të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural- zyra në Ferizaj, në Rajonin Ekonomiko – Pyjor në fshatin Neredime – Jezerc, në vendin e quajtur “Ngastra 10-Jezerc” me qëllim vjedhje, me sharrë motorike, ka prerë 1 copë trugu (lis) dru ahu të njomë boniteti III, me

diametër 54 cm, ku është hasur në vendin e ngjarjes me dëm në vëllim prej 3,79/m<sup>3</sup> dhe në vlerë të konsiderueshme të dëmit të shkaktuar.-

**Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.**

Gjykata, në kuptim të nenit 349 par.1 të KPRK-së dhe nenit 4,11, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 71 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

## **G J Y K O N**

### **ME DËNIM ME KUSHT**

**I vërtetohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 4 muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën prej 1(një) viti pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

E dëmtuara- Përfaqësuesi juridik i të dëmtuarës DBPZHR - zyra në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari I.R., që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m i**

PTH në Ferizaj sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr.1446/2020 të datës 25.11.2020 ka akuzuar I.R.nga fshati ..... komuna e Shtimës , për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së,

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar gjyqësor me dt. 13.01.2021 në të cilën përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit Valdet Avdiu, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën konform nenit 246 të KPPRK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

I akuzuari I.R. në shqyrtimin fillestar gjyqësor ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale dhe se që nga ajo ditë nuk ka shkuar në pyll. Jeton pa kurrëfar të ardhurash dhe nuk ka tokë dhe ekzistencën e siguron me ndihma të familjarëve të tij, e lut gjykatën që të i shqiptoj dënim sa më të butë.

Gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 të KPPRK-së, meqë i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, një pranim i tillë është bërë vullnetarisht edhe pas udhëzimeve të gjyqtarit konform nenit 383 par.2 të KPPK-së dhe mbështet në faktet dhe provat e kësaj çështje penale siç janë: Procesverbali i DBPZHR zyra në Ferizaj nr.435/2020 , Protokolle 26/2020 e datës 29.10.2020, si dhe Fletëparaqitja e Rojës së pyllit 46/2020 dt.29.10.2020, akuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, andaj shqyrtimi gjyqësor konform nenit 246 të KPPK-së, ka vazhduar pa fjalën përfundimtare të palëve.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesit juridik i të dëmtuarës DBPZHR- zyra në Ferizaj nuk ka marrë pjesë në shqyrtim fillestar, por konform nenit 245 par.7 të KPPRK-së prezenca e tij në këtë fazë të procedurës nuk është e domosdoshme.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 69 të KPPRK-së ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë, është i martuar me 5 /pesë/ fëmijë, pa kurrëfar të ardhurash-*jeton me ndihma të ofruara nga familjarët e tij, nuk ka tokë*, si dhe gjendjen shumë të varfër ekonomike të akuzuarit, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej veprë penale. Ndërsa,

rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata, të pandehurit i shqiptoj një dënim të kushtëzuar duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës nga neni 48 i KPRK-së, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenit 38 të KPRK-së.

Konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së, e dëmtuara- Përfaqësuesi juridik i të dëmtuarës DBPZHR - zyra në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari I. R., që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në disozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P nr.1004/20 dt.13.01.2021**

**Sek.juridike**

**Igballe Arifi**

**Gjyqtari,**

**Elmaz Zenuni**

### **KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,  
në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë.  
Ankesa dorzohet nëpërmes të kësaj gjykate.